

VENDIM
Nr. 60, datë 10.3.2025

**MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE
TË SHOQËRISË “DRINI BULQIZE” SHPK SI MJET PËR GARANTIMIN E
DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 9, pika 8, dhe nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.3.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 926/3 prot., datë 6.3.2025, të Drejtorisë së Licencimit, dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZË” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga Enti Rregullator i Energjisë për vendosjen e kuotave të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse, ‘Banka OTP Albania’ sh.a.”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “DRINI BULQIZË” sh.p.k. është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni, si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit:

- Shoqëria, më datë 11.11.2024, paraqiti në ERE aplikimin për marrjen e autorizimit për vendosjen e kuotave të saj si mjet garancie ndaj “Bankës OTP Albania” sh.a., bazuar në kontratën e datës 8.11.2024.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues:

- Shoqëria “DRINI BULQIZË” sh.p.k. është licencuar nga ERE për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 mw sipas vendimit nr. 77, datë 29.4.2024;

- Në datat 21.11.2024, 13.12.2024, 6.2.2025 dhe *email*-in e datës 17.2.2025, ERE i dërgoi shoqërisë shkresat nr. 2379/1 prot. dhe nr. 2379/3 prot., nr. 996 prot., duke evidentuar dokumentacionin e munguar dhe informacionin e nevojshëm për aplikimin.

3. Dorëzimi i dokumentacionit plotësues nga shoqëria:

- Shoqëria ka dorëzuar dokumentacion shtesë me shkresën nr. 2379/2 prot., datë 27.11.2024, si dhe me shkresën nr. 996/2 prot., datë 20.2.2025, shoqëria përcolli informacionin e kërkuar.

4. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit:

Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “DRINI BULQIZË” sh.p.k., rezulton se janë plotësuar kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

- Neni 5, pika 2 – Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, siç kërkohet nga rregullorja.

Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- Neni 5, pika 4 – Dokumentacioni është dorëzuar në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe është shoqëruar me kopje elektronike;

- Neni 5, pika 5 – Shoqëria nuk ka kërkuar kufizimin e publikimit të ndonjë pjese të dokumentacionit.

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 8:

- Pika 1 – Informacioni i kërkuar mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet e vendosjes së kuotave si garanci, përshkrimi i detyrimeve dhe deklarata mbi statusin e kuotave janë të gjitha të plotësuar;

- Pika 2 – Dokumentet e kërkuara, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimin e organeve drejtuese, marrëveshjen paraprake dhe çdo miratim shtetëror, janë të gjitha të dorëzuara;

- Pika 3 – Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit:

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave si garanci nuk e përjashton shoqërinë nga detyrimi për të marrë miratime të tjera nga autoritetet përkatëse;

- Neni 9, pika 8 – Pas miratimit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së, ku të reflektohet ky ndryshim/transferim;

- Për sa parashikuar vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj;

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave si mjet garancie ndaj palës kredidhënëse nuk e përjashton shoqërinë nga detyrimi për të marrë miratimet e organeve të tjera për këtë ndryshim, nëse kjo kërkohet;

- Shoqëria duhet të njoftojë ERE-n në rast të heqjes së barrës siguruese mbi kuotat ose ekzekutimit të detyrueshëm të tyre.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “DRINI BULQIZË” sh.p.k. si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Banka OTP Albania” sh.a. (për kontratën datë 8.11.2024).

2. Dhënia e Autorizimit nga ERE, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, nuk e çliron shoqërinë ““DRINI BULQIZË”” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria ““DRINI BULQIZË”” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj.

4. Shoqëria duhet të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë ““DRINI BULQIZË”” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

